

Në bazë të nenit 50 paragrafi (3) i Ligjit të Energjetikës\* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/19) dhe nenit 30 paragrafi (3) të Rregullores së Licencave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 51/19, 54/19, 214/19, 114/20, 246/20 dhe 44/21), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021, miratoi

## **Vendim**

### **për fillimin e procedurës për marrjen e licencës së MIST ENERXHI SHPKNJP Shkup**

1. Shoqërisë së Prodhimit, të Tregtisë dhe të Shërbimeve MIST ENERXHI SHPKNJP Shkup, si bartëse të licencës së kryerjes së veprimtarisë energjetike të furnizimit me energji elektrike, i jepet detyrim që më së voni deri më 17 tetor 2021:
  - të përgatisë dhe të dërgojë deri te MEMO SHPKNJP Shkup, si operator i tregut të energjisë elektrike, si dhe deri te SHA MEPSO Shkup, si operator i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, oraret fizike, në të cilat duhet t'i pasqyrojë transaksionet e marrëveshjeve bilaterale, me ç'rast CPS të jetë në përputhje me nevojat e konsumatorëve, që i furnizon me energji elektrike;
  - të dërgojë deri te MEMO SHPKNJP Shkup, si operator i tregut të energjisë elektrike, kopje nga marrëveshjet e lidhura bilaterale për shitjblerje të energjisë elektrike në përputhje me Marrëveshjen për Pjesmarrje në Treg;
  - t'i plotësojë detyrimet e tij ndaj konsumatorëve sa i përket sigurisë dhe vëllimit të furnizimit dhe
  - t'i paguajë sasinë e prokuruar të energjisë elektrike, si dhe kapacitetin e rezervuar dhe shërbimet e rregulluara nga operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe/ose nga operatorët e sistemeve të shpërndarjes së energjisë elektrike, në rast se kundër të njëjtëve nuk është parashtuar kundërshtim, gjegjësisht nuk ka procedurë të hapur kundërshtimi.
2. Për detyrimet e kryerja nga pika 1 dhe 2 të këtij vendimi, Shoqëria e Prodhimit, e Tregtisë dhe e Shërbimeve MIST ENERXHI SHPKNJP Shkup, si bartëse e licencës së kryerjes së veprimtarisë energjetike të furnizimit me energji elektrike, të dërgojë raport deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më vonë se 18 tetor 2021.
3. Ky vendim të dërgohet deri te MIST ENERXHI SHPKNJP Shkup, te SHA MEPSO Shkup dhe te MEMO SHPKNJP Shkup.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij dhe botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**PA1 nr.12-168/21  
7 tetor 2021  
Shkup**

**Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe  
të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së  
Veriut**

**Марко Бислимоски**